

Me çka të të peshoj,
me sy apo me zemër?

Vendi:
Grand Hotel Prishtina
28.10.2022

Kosova nuk ka Muze të Artit Bashkëkohor (MAB). Më 31 maj, 2022, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës themeloi një këshill të veçantë për inicimin e MAB, që ishte iniciativa e parë e nivelit të lartë për muze të arteve në Kosovë, i cili parashihet të funksionalizohet tërësisht deri në vitin 2026. Si do të duket ky muze, ku do të vendoset, cili do të jetë koleksioni i tij dhe çfarë ndikimi do të ketë, janë të gjitha pyetje me të cilat po ballafaqohet Këshilli. Këto janë disa nga pyetjet kyçe që nxisin një Simpozium të veçantë ndërkombëtar në Prishtinë, të organizuar nga Këshilli, më 28 tetor. Përgjigjet e nxjerra nga panelistët e shumtë e me përvojë të cilët kanë prapavija të ndryshme do të shërbejnë si shtyllë e diskutimeve dhe vendimeve të mëtejme të Këshillit.

Këshilli Inicues për Muzeun e Artit Bashkëkohor (KIMAB) përbëhet nga artistë, arkitektë dhe politikëbërës të fushës së kulturës. Ka nëntë anëtarë, përbërë nga Yll Rugova, Petrit Halilaj, Flaka Haliti, Sislej Xhafa, Erëmirë Krasniqi, Zake Prelvukaj, Nita Salihu Hoxha, Valdete Pacolli, Fisnik Abazi dhe Rozafa Imami.

Me çka të të peshoj,
me sy apo me zemër?

Vendi:
Grand Hotel Prishtina
28.10.2022

Fjalët e hapjes 10:00—10:15
Simpoziumi hapet nga Yll Rugova, kryesuesi i Këshillit Inicues për Muzeun e Artit Bashkëkohor

Paneli 1
Relevant për kë?
(Komuniteti i muzeut, në nivelin lokal, ndërkombëtar, i qëndrueshëm)
10:05—11:30

Moderator: Vullnet Sanaja
Panelistë: Övül Ö. Durmuşođlu, Joanna Warsza, Iara Boubnova, Cristiana Colli, Nita Zeqiri

Pyetja:
Cila do të ishte relevantja e këtij muzeu? Cili është kontributi më i rëndësishëm që një muze mund të bëjë për shoqërinë kosovare, duke qenë ndërkombëtarisht rezonant?

Pauzë për kafe 20min

Paneli 2
Dallohet për çfarë?
(Koleksion muzeal, Programim publik, Vizion)
12:00—13:30

Moderator: Ajola Xoxa
Panelistë: Arta Agani, Ana Janevski, Catherine Nichols, Vesa Sahatçiu

Pyetja:
Si të formulojmë një propozim të veçantë në vend të asimilimit në diskursin kulturor “Perëndimor” kur vie te koleksionimi?

Pushimi i drekës

Fjalët hyrëse, 14:30—14:35
Simpoziumi vazhdon me fjalë hyrëse nga Flaka Haliti, anëtare e Këshillit Inicues për Muzeun e Artit Bashkëkohor

Paneli 3
I zëvendësueshëm për nevojat e kujt?
(Lokacioni i muzeut, Arkitektura)
14:35—16:00

Moderator: Bekim Ramku,
Panelistë: Përparim Rama, Vala Osmani, Benjamin Foerster-Baldenius, Jon Maass

Pyetja:
Cila është nevoja dispozitive arkitektonike për një ndërmarrje të tillë? Përdorimi/transformimi i ndërtesave ekzistuese apo sjellja dhe dizajnimi i një ndërtese të re me përmasa të përshtatshme për zgjerim e rritje të mëvonshme?

Pauzë për kafe 20min

Paneli 4
Autonom ndaj kujt?
(Politikat e muzeut, Relacione kulturore, Ligj)
16:30—18:00

Moderator: Arif Muharemi
Panelistë: Hedwig Fijen, Hajrulla Çeku, Nicolas Bourriaud, Leutrim Fishekçiu

Pyetja:
Si mund ta krijojmë një institucion kulturor/ muze në Kosovë i cili do të ishte autonom në mënyrë joproblematike nëse është e mundur? Duke marrë parasysh nevojën për t'i rimenduar institucionet ndërkombëtarisht (sa u takon operimit, reprezentimit dhe mbështetjes së tyre për artistët të ndërtosh një institucion të ri nga zero është një shancë për të bërë gjërat ndryshe, cili është ndryshimi që duhet bërë?

Titulli vjen nga poezia
“Mëngjesi” nga
Ali Podrimja

Me çka të të peshoj, me sy apo me zemër?

Republika e Kosovës/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Republika Kosova/ Ministarsvo Kulture, Omladine i Sporta
Republic of Kosovo/ Ministry of Culture, Youth and Sport

